



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS

Durrës 26.01.2026

Lënda: Kthim përgjigje

Bazuar në ligjin 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", I ndryshuar, në përgjigje të kërkesës suaj ju informojmë si mëposhtë vijon:

1. Në bazë të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, çdo shtetas shqiptar ka detyrimin ligjor për të paguar taksat dhe tarifave vendore, sipas përcaktimeve të bëra nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Në zbatim të paketës fiskale në fuqi të Bashkisë Durrës, si dhe vendimeve përkatëse të Këshillit Bashkiak, është përcaktuar që mbledhja e taksave dhe tarifave vendore të realizohet nëpërmjet faturimit në konsumin e ujit, ku Shoqëria Rajonale e Ujësjetës-Kanalizimeve Durrës (SHRUKD) vepron si agjent mbledhës.

Për këtë arsye, të gjitha taksat dhe tarifave vendore (si p.sh. taksa e pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit etj.), faturohen së bashku me faturën e ujit, pavarësisht nivelit të shërbimit të perceptuar, pasi këto detyrime burojnë nga ligji dhe jo nga një kontratë individuale shërbimi.

Bashkia Durrës, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse, është e angazhuar për përmirësimin e shërbimeve publike dhe adresimin e problematikave infrastrukturore në territorin e saj, në përputhje me planifikimet dhe fondet e miratuara.

2. Ndërmarrja Rruga, si njësi në varësi të Bashkisë Durrës, ka në kompetencë pastrimin dhe mirëmbajtjen e kanaleve të hapura të ujërave të shiut. Kanalizimet e mbyllura nuk janë pjesë e fushës sonë të përgjegjësisë ligjore dhe funksionale.

Në fillim të cdo viti hartohet plani i punës për pastrimin e kanaleve kulluese, bazuar në problematikat e raportuara nga njësitë administrative përkatëse. Këto problematika na përcillen zyrtarisht dhe në vijim ndërmarrja jonë bën planifikimin dhe ndarjen e punimeve sipas rëndësisë së ndërhyrjes.

Aktualisht Njësia Administrative Katund I Ri ka përcjellë listën e kanaleve që paraqesin nevojën për pastrim për vitin 2026, mbi bazën e së cilës po bëhet planifikimi I ndërhyrjeve përkatëse.

Gjatë vitit 2025, Ndërmarrja Rruga ka kryer ndërhyrje emergjente në disa kanale problematike, me qëllim minimizimin e rrezikut të përmytjeve dhe garantimin e funksionit të pjesshëm, të sistemit kullues. Këto ndërhyrje janë realizuar në kanalet e listuara më poshte:

| | | |
|--------------------|-------------|----------------|
| KK-2M Sektor Rinia | Katund I Ri | 1200 |
| KK-2 Sektor Rinia | Katund I Ri | 3500 |
| KK – 2 Bisht Kamez | Katund I Ri | 450 |
| Kk – 2 Bisht Kamez | Katund I Ri | 600 |
| KK – 3 | Katund I Ri | 2100 |
| Kk – 3 | Katund I Ri | 1500 |
| TOTAL: | | 9350 ml |

Sa i përket zonave të njohura si: “Stallat e Reja” dhe “Kanali Gjerman”, nuk janë në kompetencën e Ndërmarrjes Rruga.